

OSHEE GROUP sh.a njofton mbi hapjen e vendeve vakante **Specialist** pranë OSSH / Drejtoria Rajonale Tiranë / Dega Teknike.

SPECIALIST

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Harton plane vjetore dhe mujore të veprimtarisë së sigurimit teknik në zbatim të dispozitave ligjore që kanë lidhje me sigurimin e gjendjes së punës.
- Harton kërkesat materiale për plotësimin e infrastrukturës së sigurisë dhe higjenës në punë (duke bashkërenduar vazhdimisht me Njësitë dhe Agjensitë e Rajonit për kërkesat materiale që ato kanë).
- Realizon kontrole periodike në të gjitha Njësitë dhe Agjensitë e Rajonit në sistemet e rrjeteve TU, TM, TL si dhe kabinat e transformacionit.
- Informon me shkrim Shefin e Asistencës Teknike dhe Njësite apo Agjensitë përkatëse për mangësitë e konstatuara në rrjetet TU, TM, TL dhe kabinat e transformacionit.
- Analizon rastet e aksidenteve të çfarëdo lloji të ndodhura në Njësi apo Agjensi duke nxjerrë konkluzionet dhe përgjegjësitë përkatëse.
- Bashkëvepron veprimtarinë e tij me qendrat e specializuara të kontrollit të veglave dhe mjeteve të punës duke kërkuar me rigorozytet që të zbatohen kontrollet periodike të tyre.
- Kontrollon objektet që ndërtohen nën linjat elektrike TU, TM, TL si dhe veprimtaritë që kryhen në kabinat e transformacionit jashtë kushteve të sigurimit teknik. Për konstatimet e bëra informon me shkrim Shefin e Sektorit të Asistencës Teknike.
- Çdo muaj informon Shefin e Sektorit të Asistencës Teknike për punën e bërë.
- Detyra të tjera, të ngarkuara nga Eprori i drejtpërdrejtë.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Të ketë përfunduar Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike.
- Të ketë eksperiencë pune mbi 2 vjet.
- Të ketë njohuri për programet bazë të kompjuterit.
- Të ketë njohuri të gjuhës angleze.
- Aftësi shumë të mira komunikuese edhe punës në grup.

Të gjithë kandidatët e interesuar janë të lutur të bëjnë aplikimin në websiten e OSHEE group, në portalin e punësimit.

Ju njoftojmë se vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen për intervistë.